

## De Biasi publikon listen e lojtareve, mungon Gashi

nga Administrator

E shtunë, 01 Tetor 2016 12:14

---



Tranjeri i kombetares shqiptare Gianni de Biasi ka dale ne nje konference per shtyp ku ka shpallur listen e lojtareve per 2 ndeshjet e ardhshme kunder Lihtenshteinit si edhe kunder Spanjes. Ne kete liste bie ne sy afrimi i disa lojtareve te ekipit U-21 si edhe rikthimi i Azdren Lullakut, i cili po kalon nje forme shume te mire ne kampionatin rumun. Gjithashtu ajo qe ra ne sy eshte edhe mos thirrja e Shkelzen Gashit, i cili kete jave shenoi nje supergol me ekipin e tij amerikan Kolorado Rapids.

Gianni de Biasi e ka justifikuar mos thirrjen e Gashit, me faktin se ne keto ndeshje do ti jap me shume hapesira lojtareve te rinj te U-21. Gjithashtu ai eshte shprehur se ndeshja kunder Lihteshteinit eshte shume e veshtire dhe lojtaret duhet te perqendrohen maksimalisht per te marre fitoren.

Ja edhe lista e plote e lojtareve te thirrur:

**Portierë:** Etrit Berisha, Orges Shehi, Alban Hoxha.

**Mbrojtës:** Ansi Agolli, Berat Gjimeshiti, Mërgim Mavraj, Elseid Hysaj, Naser Aliji, Frederic Veseli.

**Mesfushorë:** Amir Abrashi, Burim Kukeli, Migjen Basha, Jahmir Hyka, Ergys Kaçe, Andi Lila, Taulant Xhaka, Ledjan Memushaj, Odise Roshi, Ermir Lenjani, Eros Grezda, Liridon Latifi.

**Sulmues:** Bekim Balaj, Sokol Çikalleshi, Rei Manaj, Armando Sadiku, Azdren Llullaku.

Ndeshja kunder Lihteshtain do te luhet ne Vaduz me date 6 tetor ora 20:45, ndersa ndeshja kunder Spanjes do te luhet ne Shkoder, te dielen date 9 tetor po ne oren 20:45.